

UDHËZIM
Nr.2, datë 4.1.1992

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7514, DATË 30.9.1991 “PËR PAFAJËSINË, AMNISTINË DHE REHABILITIMIN E ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË”

Për zbatimin e ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Personat që, në bazë të neneve 1 dhe 5 të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991, janë të pafajshëm, për efekt të përfitimit nga sigurimet shoqërore, u njihet vjetërsi pune, në marrëdhënie me shtetin, e kategorisë së parë, koha e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë dhe me internim, kur internimi është dhënë si dënim penal plotësues.

Personave të pafajshëm, që para se të ndiqeshin penalisht kanë qenë në marrëdhënie pune, për të cilët jepet pension për vjetërsi shërbimi, koha e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë dhe me internim si dënim penal plotësues u njihet e vlefshme për pension për vjetërsi shërbimi.

2. Personi i pafajshëm, për kohën që ka punuar gjatë vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë, ka të drejtë që për efekt pensioni të zgjedhë pagën e punonjësit në gjendje të lirë, që ka punuar në kushte të njëjta pune me atë që ka kryer personi gjatë vuajtjes së dënimit. Dokumenti i pagës për periudhën e punuar gjatë vuajtjes së dënimit jepet nga administrata e repartit ku është vuajtur dënimi. Në këto raste paga nxirret nga listëpagesat dhe llogaritet çdo muaj në bazë të kategorisë personale ose të punës së të dënuarit dhe përqindjes së realizimit të normës. Kur përcaktimi i pagës nuk mund të bëhet për shkaqe të ndryshme, personit të pafajshëm i jepet pensioni mesatar, që do të konsiderohet mesatarja ndërmjet kufirit minimal e maksimal të pensionit që parashikon ligji. Për shembull, mesatarja e pensionit të plotë të pleqërisë do të merret në masën 855 lekë në muaj, duke e llogaritur në këtë mënyrë: $(660+1050):2$. Kur kërkohet që paga mesatare të merret si nga koha e vuajtjes së dënimit, ashtu dhe nga koha para ose pas vuajtjes së dënimit, paga mesatare do të llogaritet mbi të ardhurat e realizuara gjatë tre vjetëve me radhë.

3. Anëtarët e familjes së personave që përmenden në shkronjën “e” të nenit 5 të ligjit përfitojnë pension familjar. Përlllogaritja e pensionit do të bëhet sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij udhëzimi. Kur mbajtësi i familjes nuk ka pasur vjetërsi në punë, sipas ligjit, do t’i jepet pension familjar mesatar. Ky pension do të përlllogaritet si mesatare ndërmjet minimumit dhe maksimumit të pensionit familjar dhe sipas numrit të pjesëtarëve të familjes në ngarkim.

4. Të drejtat e mësipërme në fushën e sigurimeve shoqërore i përfiton edhe personi i dëbuar ose i internuar për shkaqe politike, në bazë të dokumentit që do të paraqesë për shkakun dhe kohën e vuajtjes së këtyre dënimeve.

5. Për të përfituar të drejtat që parashikon ligji “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” në fushën e sigurimeve shoqërore, të interesuarit e pafajshëm duhet të paraqesin në organet e sigurimeve shoqërore të rrethit dokumentet përkatëse, ndër të cilat edhe vërtetimin për kohën e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë për kohën e vuajtjes së dënimit me internim si dënim penal plotësues, për kohën e vuajtjes së dënimit si i dëbuar ose i internuar për shkaqe politike, si dhe për rastet e pushkatimit pa gjyq etj. Ky vërtetim do të lëshohet nga Ministria e Rendit Publik, e cila bashkëpunon për këtë me Ministrinë e Drejtësisë.

6. Kur dokumentet mungojnë, koha e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë me internim, si dënim penal plotësues, si dhe fakti i vdekjes së personit në burg pa qenë i dënuar, i pushkatuar pa gjyq e në kushte të tjera që përmenden në shkronjën “e” të nenit 5 dhe të nenit 7 të ligjit të mësipërm, vërtetohet me komision. Rregullat për krijimin dhe funksionimin e komisionit caktohen nga Ministria e Rendit Publik, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.

Për rastet kur dokumentet mungojnë, koha e vuajtjes së dënimit administrativ me internim e dëbim për shkaqe politike, do të vërtetohet sipas rregullave të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.445, datë 13.12.1991 “Për vërtetimin e kohës së vuajtjes së dënimit administrativ nga ish-të internuarit

dhe të dëbuarit për çështje politike, kur mungojnë dokumentet zyrtare”.

7. Nëse personi është dënuar dhe ka vuajtur dënimin për vepra penale, për të cilat quhet i pafajshëm sipas nenit 1 të ligjit, ashtu edhe për vepra penale që nuk quhet i pafajshëm, Ministria e Rendit Publik, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të përcaktojnë rregullat e llogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit, që do të njihet si vjetërsi pune ose shërbimi. Edhe për këto raste, vërtetimi për kohën që njihet vjetërsi pune ose vjetërsi shërbimi, lëshohet nga Ministria e Rendit Publik.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Vilson Ahmeti